

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Takimi mes Lavrov dhe Wadephul, Kallas: Tallja e Rusisë në OKB tregon se nuk i intereson t'i japë fund l uftës në Ukrainë
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/takimi-mes-lavrov-dhe-wadephul-kallas-tallja-e-rusise-ne-okb-tregon-se-nuk--i589054
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 20:17:02 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 20:40:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	7dfe82cb1ca798ac1067962c13199295e166ed98867d5681e3b9f26a6badf88d
TEKSTI	69732273c926e3fcb9f5c083cbfa620337f00e9851224262468bae75c10a038
PAMJA	9e3ce6e7761d5e9969b067abcb96726b01ad7617d819420c3a3bd921cc8246ec

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	914f4ebaa3635575ed848eaf171c6ef7543beda6ee75f347b7eac22812a2409c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	6a4afcd2fdba1fd2c3f5e26c1cb3946785567999c2c435268418bbbf9bbb6
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/914f4ebaa3635575ed848eaf171c6ef7543beda6ee75f347b7eac22812a2409c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

English

Built and Monetized by



English



Google teston përdorimin e inteligjencës artificiale në hapësirë! Deshton tentativa e hyrjes së 10 shqiptareve në Angli, po transportoheshin me një gomone me motore të fuqisë

Takimi mes Lavrov dhe Wadephul, Kallas: Tallja e Rusisë në OKB tregon se nuk i intereson t'i japë fund luftës në Ukrainë



28 Shtator 2026, 22:40 Bota TEMA



Shefja e politikës së jashtme të Bashkimit Evropian, Kaja Kallas, tha të hënën se mënyra se si ministri i Jashtëm i Rusisë, Sergei Lavrov, u soll me homologun e vet gjerman, Johann Wadephul, pas takimit të tyre rishtazi në OKB, tregon se Rusia nuk është e interesuar për paqe në Ukrainë.

Takimi i 26 shtatorit mes Lavrovit dhe Wadephulit u zhvillua në margjinat e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së në Nju Jork dhe ishte takimi i parë mes ministrave të Jashtëm të Gjermanisë dhe Rusisë që nga fillimi i pushtimit në shkallë të plotë të Ukrainës nga Moska, në fillim të vitit 2022.

Si në fjalimin e tij në Kombet e Bashkuara më vonë atë ditë, ashtu edhe në një konferencë pasuese për media, Lavrovi u tall me takimin me Wadephulin dhe hodhi poshtë thirrjet e Gjermanisë për ndalimin e sulmeve ndaj Ukrainës, të cilat ditët e fundit kanë shkaktuar viktima të shumta në mesin e civilëve.

"Ka shumë vende jashtë Evropës që thonë: 'Flisni me rusët dhe pastaj do të ketë rezultat (në Ukrainë)'", tha Kallas, duke iu referuar sjelljes së Lavrovit.

"Por kjo bisedë [mes Wadephulit dhe Lavrovit] tregon se Rusia me të vërtetë nuk është aspak e interesuar për paqe. Përndryshe, nuk sillet në këtë mënyrë me bashkëbiseduesin e vet", tha ajo.

Kallas tha se gjatë takimit Wadephuli kishte ngritur nevojën për shtensionimin e luftës në Ukrainë, si dhe sulmet hibride në Evropë.

Në fillim të shtatorit, Berlini e fajësoi Rusinë për incidente me dronë që në gusht shkaktuan ndërprerjen e trafikut në aeroportin e Lajpcigut.

Duke i hedhur poshtë thirrjet për shtensionim, Lavrovi këmbënguli se luftimet "do të vazhdojnë deri në fund".

Ai e akuzoi Berlinin se është mbështetësi kryesor i Ukrainës dhe se po përpiqet të bëhet sërish fuqi ushtarake udhëheqëse në Evropë.

"A e kupton Berlini se ku mund të çojë kjo?", pyeti ai në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, duke shtuar: "A nuk i kanë mësuar ata mësimet e Luftës së Dytë Botërore?"

Ai tha gjithashtu se Moska do të vendoste veto ndaj çdo përpjekjeje të Gjermanisë për të siguruar një ulëse të përhershme në Këshill të Sigurimit të OKB-së, nëse ky institucion, organi më i fuqishëm i Kombeve të Bashkuara, do të zgjerohet./ REL

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Dështon tentativa e hyrjes së 10 shqiptarëve në Angli, po transportoheshin me një gomone me motorë të fuqishëm!](#)

22:00 Bota

"Kjo është beteja e fundit" / Spotet e Trump ndezin polemika, opozita: Propagandë e paligjshme e paguar nga taksapaguesit

21:50 Bota

BE ka një "surprizë" për Shqipërinë! "Politico" zbulon se do ketë strategji më vete për 4 vendet që janë pranë anëtarësimit në Union

21:10 Bota

Sulm ajror në një treg në Myanmar, 33 të vrarë dhe 36 të plagosur (VIDEO)

21:00 Bota

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.